

Ka diçka që ne duam që ju të dini.....

.... mbi Vlerësimin e Kujdesësit

Kujdesësit kanë të drejta gjithashtu!

Nëse jeni kujdesës i papaguar që kujdeset për partnerin, një anëtar familjeje apo një shok që nuk mund t'ia dalë mbanë pa ju, ju keni të drejtë për të pasur një vlerësim kujdesësi.

Një ligj i ri – **Akti i Kujdesësve (Shanset e Barabarta)** – synon që t'u japë kujdesësve më shumë zgjedhje dhe shanse më të mira.

Ju nuk keni nevojë të jetoni me personin për të cilin kujdeseni, dhe ju keni të drejtë të keni një vlerësim edhe nëse nuk doni ndihmë nga Shërbimet e Socialit.

Kujdesësit janë të të gjitha moshave. Një kujdesës mund të jetë:

- një i rritur që kujdeset për një të rritur
- një i rritur që kujdeset për një fëmijë me paaftësi
- një person i ri nën moshën 18 vjeç që kujdeset për një prind

Përse ju duhet vlerësimi

Vlerësimi ju jep rastin që të diskutoni çfarëdo ndihme që ju nevojitet mbi kujdesin dhe për të mbajtur shëndetin dhe mirëqenien tuaj. Diskutimi do të bëhet zakonisht me dikë nga Shërbimet e Socialit apo një profesionist shëndetësor apo ndonjë vlerësues i pranuar tjetër për kujdesës.

Shërbimet e Socialit do të përdorin vlerësimin për të vendosur çfarë ndihme dhe mbështetje t'ju ofrojnë.

Çfarë përfshin vlerësimi?

Vlerësimi i nevojave tuaja zakonisht bëhet në një takim ballë për ballë, ndonjëherë në të njëjtën kohë kur edhe bëhet vlerësimi i kujdesit të komunitetit për personin që ju kujdeseni, nëse të dy pajtoheni për këtë.

Nga ana tjetër, ju mund të kërkonit për një vlerësim në një kohë tjetër. Ju mund të keni një shok apo përkrahës me ju për t'ju ndihmuar që të shprehni nevojat tuaja.

Pyetjet për të cilat do t'ju pyesim

- Çfarë detyrash bëni si kujdesës?
- A jeni në gjendje dhe a doni të vazhdoni të kujdeseni?
- A punoni, apo a dëshironi të punoni?
- A doni të bëni ndonjë trajnim apo edukim për të rritur?
- A keni ndonjë aktivitet të lirë që tani nuk mund ta ndiqni për shkak të rolit tuaj si kujdesës?

Shërbimet e Socialit mund t'ju japin ndihmë dhe mbështetje direkt ndaj jush, ose të ndihmojnë drejtpërdrejt personin për të cilin kujdeseni.

Çfarë ju duhet të bëni

Mendoni për nevojat tuaja dhe përpiquni të jeni të qartë mbi atë se çfarë niveli të kujdesit ju mund të përballoni.

Pas vlerësimit tuaj

Ju do të merrni një kopje të vlerësimit dhe planin e mbështetjes për të cilin ju dhe vlerësuesi jeni pajtuar. Nëse keni kërkuar ndonjë shërbim, ju gjithashtu do të merrni konfirmim të financimit që kjo është pajtuar.

Ne do të sigurojmë që ju të keni informata mbi:

- çfarë do të ndodhë më tej
- kë të kontaktoni për mbështetje
- datën kur do të rishqyrtojmë nevojat tuaja për tu siguruar që ndihma e dhënë po bën punë.

Nëse nuk jeni të kënaqur me rezultatin e vlerësimit, ju mund të sfidoni vendimin apo të bëni ankesë.

Si të kërkonti një vlerësim

Tregoni menaxherit të kujdesit apo koordinatorit të kujdesit të personit për të cilin kujdeseni. Nëse nuk jeni në kontakt me dikë nga Shërbimet e Socialit, kontaktoni:

Carers Support Team
Haringey Social Services
40 Cumberland Road
London N22 7SG

Tel: 020 8489 3967

Email: carerssupportteam@haringey.gov.uk